

eppc kërkon **Layout Designer** për klientin e saj, kompani më e madhe ndërkombëtare në fushën e përkthimeve.

Përgjegjësitë Kryesore:

1. Ndërhyn dhe bën modifikimet e nevojshme në *layout* dokumentash sipas kërkesave dhe nevojave të klientit;
2. Rishikon dhe korrekton fontet dhe përpunimin grafik dhe gjuhësor;
3. Redakton grafika të tilla si: fotografi apo ilustrime;
4. Përshtat dhe bën modifikimet e nevojshme vizive në slide dhe prezantime, sipas udhëzimeve specifike që vijnë nga klienti;
5. Ndjek me përpikmëri që të gjitha modifikimet dhe korrektimet vizive janë kryer sipas udhëzimeve dhe manualeve teknike;
6. Bashkëpunon ngushtë me Specialistin e Kontrollit të Cilësisë në mënyrë që e gjithë puna të kryhet me cilësinë e kërkuar dhe konform rregullave të parashtruara;
7. Kujdeset që çdo projekt të përfundojë dhe të dorëzohet me cilësi brenda afateve të përcaktuara nga klienti.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare në **Informatikë/Design**;
- Përvojë e mëparshme pune si **Designer, Graphic Designer, Layout Designer**;
- Të njohë dhe zotërojë shumë mirë **Adobe Indesign, Illustrator, Photoshop**;
- Të **zotërojë shumë mirë Gjuhën Angleze** në të shkruar dhe të folur;
- Të zotërojë shkëlqyeshëm paketën MS Office;
- Të ketë njohuri të mira kompjuterike të Mac;
- Të jetë i mirëorganizuar dhe i orientuar drejt detajeve.

Të dhënat:

Pozicioni:	Layout Designer;
Vendndodhja:	Tiranë;
Orari:	40 orë në javë;
Pagesa:	Shumë e mirë;
Kontrata:	Sipas Kodit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	05.02.2016.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail^{it}:

recruitments@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.

Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.